



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 433/ 2 prot.,

Datë 01.03.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-55558-12-30-2022, me objekt “*Shërbim i pastrimit të ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave*”, me fond limit 17,507,638 (*shtatëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë*) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK  
Adresa: Rruga “*Fatmir Haxhiu*”, Pall. 2, Shk. 10, Ap. 76, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara  
Adresa: Blv “*Dëshmorët e Kombit*” Nd.1, 1001, Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “*Silver*” SHPK  
Adresa: Rruga “*Bajram Curri*”, Pall. 1 Maj, God 7, Shk 4, Kt. 1, Tiranë.

Në datën 28.02.2023 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. Elektronik A/2023/2912, dhe nr. 433/2023 prot, datë 28.02.2023 e operatorit ekonomik “*Pastrime Silvio*” SHPK për procedurën e “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-55558-12-30-2022, me objekt “*Shërbim i pastrimit të ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave*”, me fond limit 17,507,638 (*shtatëmbëdhjetë milion e*

pesëqind e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 24.01.2023 nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Pastrime Silvio” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 433 prot., datë 28.02.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- **Arsyet e skualifikimit:**

Në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2 seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik” të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, sipas Shenimit 2.1, “Ne cdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi fitues duhet që të dorëzojë dokumentacionin provues sipas profilit të cdo punonjesi prane AK.” Pas verifikimit të dokumentacionit të përcjellë në formë të shkruar nga ofertuesi “PASTRIME SILVIO” SH.P.K. protokolluar me tonen nr. 306 date 20.02.2023 rezultoi se, Ofertuesi nuk përmbush pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, në lidhje me profilet e detyrueshme të stafit kryesor, dhe konkretisht për funksionin “Drejtues Teknik me profil inxhinier mjedisi”. Ofertuesi ka deklaruar në tabelën e stafit, punonjesin O.M. në rolin e Drejtuesit Teknik. Nderkohe që, pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur në formë të shkruar, nuk rezultoi që ky punonjes të ketë diplomë për “Inxhinier mjedisi”, sic kërkohet në pikën 2, seksioni 2.3 “Kapaciteti Teknik” të Kriterëve të Vecanta për Kualifikim, por ka diplomë në “Inxhinieri Agromjedisi”. Bazuar në paragrafin e fundit të Shtojcës 8 të DST, “Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim”.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 01.03.2023.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Florent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**